



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.208, datë 18.06.2020

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}
TË KATËR KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET
NR. 88, NR. 90 DHE NR. 91, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR,
VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE
TË KANDIDIMIT DHE FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 88, nr. 90 dhe nr. 91, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, si dhe në Vendimin nr.157, datë 15.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe në Vendimin e tij nr. 190, datë 04.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e saj, znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, nr. 90 dhe nr. 91, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, nr. 90 dhe nr. 91, datë 26.02.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR